



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 133, Datë 21.05.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“5GX ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR
10 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1570/1 prot., datë 19.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1570 prot., datë 12.05.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 10 MW.
- Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 04.05.2023 dhe Kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.06.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) shoqëria është pajisur me të drejtën Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.
- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores e po ashtu ka shlyer dhe pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave (c, d, e, f dhe g).
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gërma “a” të Rregullores, shoqëria duhet të depozitohet në ERE Shtojcën 1 të plotësuar dhe në lidhje me gërmën “b” duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe kapacitetit të secilës.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI